



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:046589
Datë: 11.03.2025
Numri i dokumentit: 06971628

AA.nr.992/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, D.D nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me autorizim, Petrit Dushi avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, përkritazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.507/2022, të datës 02.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.03.2025, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.507/2022, i datës 02.10.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.507/2022, të datës 02.10.2024, është vendosur, “*I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, D.D nga Prishtina, anulohet vendimi i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve Punës Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, nr.6961 i dt.26.04.2022, dhe ndryshohet vendimi i të paditurës nr.6961 i dt.11.03.2019, me të cilin paditësit i është njohur e drejta në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të Grupit të Dytë, dhe paditësit i njihet e drejta në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të Grupit të Parë, në shumë prej 375.00euro (treqind e shtatëdhjetë e pesë euro) për muaj në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh dhe atë, nga data:28.02.2024 e deri me dt.28.02.2029, të gjitha këto me kamatë ligjore në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi ditësh, nën pasojat e përmbarimit me detyrim. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës”.*

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e

të paditurës, të ndryshohet aktgjykimi A.nr.507/2022, i datës 02.10.2024 dhe të refuzohet në tersi si e pa themeltë kërkesëpadia e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar paditësi D.D përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, Petrit Dushi, avokat nga Prishtina, duke propozuar që ankesa të refuzohet, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të paditurës, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës, i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, e dt.26.04.2022, është refuzuar ankesa e paditësit, dt.31.01.2022 për njohjen e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, me datë 08.03.2022, ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve të goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Me vendimin e të paditurës, i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, e dt.26.04.2022, është refuzuar ankesa e paditësit, dt.31.01.2022 për njohjen e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik. Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, me datë, 08.03.2022, ushtron padi në këtë gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij. Nga vendimet e kontestuar rrjedhin se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit të organit të shkallës së dytë, i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Se pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë, pretendimet ankimore, provave materiale mjekësore të bashkangjitura, në seancën e mbajtur me dt.15.04.2022 nga mjekë specialistë të lëmisë përkatëse, është konstatuar që ankesa e juaj nuk është në harmoni me pikën 1 të nenit 8

të Ligjit me nr.05/L-067, prandaj ankesa refuzohet si e pabazuar, derisa mbetet në fuqi vendimi i mëparshëm”. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se vendimi i organit të paditur, i mungon arsytimi ashtu siç është përcaktuar në nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ngase nga vendimi, përkatësisht arsytimi i vendimit duhet ti siguroj palës mundësinë që ta kuptoj aktin administrativ, të këtë, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve dhe në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Ndërsa mungesa e një arsytimi që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Ndërsa me vendimin e të paditurës të shkallës së parë të dt.11.03.2019, gjykata vëren se paditësit i është njohur e drejta në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, në Grupin e Dytë nga dt.18.01.2019 në shumë prej 150 euro për muaj, për periudhën kohore prej tre viteve. Vendimin e shkallës së dytë të dt.26.04.2022, gjykata e ndryshon për faktin se në bazë të ekspertizës së dt.28.02.2024, të nxjerrë sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, të përgatitur nga tre (3) profesionistëve të fushave përkatëse të mjekësisë, të caktuar për këtë ekspertizë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, të cilët pasi kanë ekzaminuar paditësin drejtpërdrejtë kanë nxjerrë përfundim se “Në bazë të të dhënave anamnesitike, dokumentacionit mjekësor që bashkëngjitet lëndës, ekzaminimeve specializimi stikë nga ana e eksperteve të lëmisë neurologjike, urologjike dhe fiziatrike konkludojmë se pacienti ka dëmtime të rënda neurologjike me pasoja të përhershme dhe se për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore ka nevojë për ndihmën e përcjellësit”. Kjo gjykatë pas administrimit të provave si me lart pasi i ka vlerësuar një nga një provat i fali besimin raporteve mjekësore të paditësit, vendimit të paditurës i dt.11.03.2019 me të cilin paditësit i është njohur kjo e drejtë për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në grupin e dytë në periudhën kohore për 3 viteve të cilin edhe e ndryshoi, e në veçanti ia fali besimin ekspertizës të dt.28.02.2024, të nxjerrë sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, në përbërje prej tre (3) profesionistëve të fushave përkatëse të caktuar nga QKUK për këtë ekspertizë, të cilët pasi kanë ekzaminuar pacientin, kanë nxjerrë përfundim “Se pacienti ka dëmtime të rënda neurologjike me pasoja të përhershme dhe se për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore ka nevojë për ndihmën e përcjellësit”. Po ashtu, kjo gjykatë ka vlerësuar si provë dhe vlerësimin Komisionit Mjekësor të paditurës, për faktin se pikërisht këto Komisione Mjekësore, i kanë njohur këtë pension për periudhën kohore prej 3 viteve ankuesit, duke theksuar se është person i cili i plotëson kushtet ligjore për kompensim të grupit të dytë. Ndërsa nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se gjendja e tij shëndetësore nuk ka ndryshuar dhe këtë fakt e vërtetoi dhe ekspertiza e QKUK-së, e nxjerrë në procedurë gjyqësore. Nga të gjitha këto arsye kjo gjykatë nuk mundi të falë besimin mendimit dhe konstatimit të Komisionit Vlerësues të paditurës të dt.15.04.2022, si provë e vetme se paditësi nuk i plotëson kushtet që ti njihet e drejta në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë. Gjykata, për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, u bazua në ligjin Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenit 1, i cili përcakton se “Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor”. Ndërsa neni 7, paragrafi 2 i të njëjtit ligj përcakton se “Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij”.

Kurse neni 8 pika 1 e të njëjtit ligj përcakton se “Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”. Kjo gjykatë vlerësoj dhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, mirëpo të njëjtat i vlerëson si të pa bazuara, nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është vërtetuar se paditësi i plotëson kërkesat e ligjit për njohjen e të drejtës për kompenzim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë”.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të LPK-së, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPK-së, LKA-së dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi jo i drejtë e gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, kur ka vlerësuar se “vendimi i organit të paditur, i mungon arsyetimi ashtu siç është përcaktuar në nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ngase nga vendimi, përkatësisht arsyetimi i vendimit duhet ti siguroj palës mundësinë që ta kuptoj aktin administrativ, të këtë, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve dhe në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Ndërsa mungesa e një arsyetimi që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Ndërsa me vendimin e të paditurës të shkallës së parë të dt.11.03.2019, gjykata vëren se paditësit i është njohur e drejta në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, në Grupin e Dytë nga dt.18.01.2019 në shumë prej 150 euro për muaj, për periudhën kohore prej tre viteve. Vendimin e shkallës së dytë të dt.26.04.2022, gjykata e ndryshon për faktin se në bazë të ekspertizës së dt.28.02.2024, të nxjerrë sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, të përgatitur nga tre (3) profesionistëve të fushave përkatëse të mjekësisë, të caktuar për këtë ekspertizë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, të cilët pasi kanë ekzaminuar paditësin drejtpërdrejtë kanë nxjerrë përfundim se “Në bazë të të dhënave anamnesitike, dokumentacionit mjekësor që bashkëngjitet lëndës, ekzaminimeve specializime stikë nga ana e eksperteve të lëmisë neurologjike, urologjike dhe fiziatrike konkludojmë se pacienti ka dëmtime të rënda neurologjike me pasoja të përherëshme dhe se për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore ka nevojë për ndihmën e përcjellësit.” Kurse këtë

ekspertizë nuk e ka kundërshtuar as paditësi, e as e paditura pas dorëzimit të saj me dt.12.09.2024, e as në seancën e dt.02.10.2024, në të cilën kanë prezantuar mjekët, e në të cilën është thirrur e paditura në mënyrë të rregullt dhe nuk ka marrë pjesë.

Prandaj, kolegji i apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka bërë edhe aplikim e të drejtën materiale, kolegji i apelit nuk i aprovoj, për faktin se aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit dhe se e njëjta drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenit 1, 7 par.2, dhe neni 8 par.1 të tij, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të kontestuar.

Nga e gjithë kjo që u theksua më lartë dhe mbi këtë gjendje, faktike kolegji i apelit konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, dhe se thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Gjykata e shkallës së parë, ngase aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, në këtë kuptim ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.992/2024, datë 03.03.2025

Kryetar i kolegjit
Hajriz Hoti